

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje gaz I lëshem per ngrohje dhe gatim

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09122110-4 - Gaz i lëshëm propan, 09122210-5 - Gaz i lëshëm butan,

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,248,750(Njemilion e dyqind e dyzet e tetemije e shtateqind e pesedhete) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Shkodër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

.....

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021 dhe 2022) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës e përkatësisht **499,500** (katerqind e nentdhjete e nentemije e peseqind) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM ”Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti koonraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Konraktor.

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ku te paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “**Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare**”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2023 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Janë kërkuar këto kritere në përputhje me nenin 77, pika 5 të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit në një vlerë prej **249,750 (dyqind e dyzet e nentemije e shtateqind e pesedhjetë) lekë**, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i paisur me licence kodi VIII.1.A leshuar nga QKB si dhe te disponoje nje pike per mbushjen e bombulave te gazit e paisur me leje mjedisi e tipit B per gaz natyror aromatik apo GNL kodi III.1.B leshuar nga QKB, Vërtetim teknik te leshuar nga ISHTI ose organizma te akredituar si dhe Akt-Teknik te leshuar nga PMNZH per piken e tregtimit te gazit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, germa a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentim

Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të -Ligjit nr. 8450, date 24.02.1999 “Për Përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar”,

- *Vendimit Nr. 212 datë 16.3.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN”*,

- Ligjit 10489/2011 “Për mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar,
- VKM nr. 1047 datë 16.07.2008 Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr. 170 date.25.04.2002 te Keshillit te Ministrave “Per pecaktimin e procedurave dhe kushteve per dhenien e lejeve dhe te autorizimeve, per tregtimin e naftes, gazit e nenprodukteve te tyre”, te ndryshuar,

- Ligjin nr. Nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”,

- Ligjit nr. 32/2016 “Për sigurinë e punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion”,

- Urdhrin nr. 128, date 08.04.2016 “Për miratimin e procedurave për kontrollin teknik të vlerësimit të konformitetit të bombolave të GLN.

Argumentim: Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh që ofertuesi për piken e tregtimit me shumicë duhet të disponojë në përputhje me legjislacionin e mesipërme licencat e mesipërme.

2.3.2 Në rast se operatori ekonomik ofertues është subjekt i tregtimit me pakicë të gazit të lëngshëm (GLN), atëherë ai duhet të praqesë kontratë të vlefshme për furnizimin me bombula të mbushura me GLN me shoqëritë e tregtimit me shumicë si dhe "Licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë, për lëndën djegëse gaz të lëngshëm të naftës (GLN)", të lëshuar nga organet kompetente të autorizuar me ligj.. (Në zbatim të VKM Nr. 212, datë 16.3.2016 "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)".

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Ky kriter është vendosur bazuar në dispozitat e Vendimit Nr. 212 datë 16.3.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN",

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjese të stafin të tij të paktën 1 punonjës të certifikuar nga ISHTI ose organe të akredituara, me përvojë për përdorimin e paisjeve nën presion.

Për të vertetuar këtë ai duhet të paraqesë listepagesën e muajit të fundit si dhe dokumentin që verteton certifikimin e punonjësit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet në rastin kur operatori shpallet fitues ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe 40, pika 5, gërma c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi: Kjo pikë është kërkuar pasi personi që do të bëjë instalimin e bombolave të gazit nëpër shkollë duhet të jetë i certifikuar nga organet përkatëse

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise përgjatë vitit 2023

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter eshte vendosur bazuar ne Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 212 datë 16.3.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN”, pasi AK kërkon te garantohet qe subjektet ofertuese e zhvillojne veprimtarine ne perputhje me rregullat e percaktuara ne legjislacionin per tregtine e gazit..

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te deklaroje se merr persiper qe te konvertoje te gjitha tollonat ne leng, deri ne perfundimin e plote te kontrates, sipas nevojave te autoritetit kontraktor..Tollonat do te jene 15 kg.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë një deklaratë me ane te se ciles merr përsipër që te beje dorëzimin e lëndës djegëse (GLN) pranë autoritetit kontraktor, të shoqëruar me fleta analiza të produktit të lëshuara nga laboratorë të akredituar apo të autorizuar nga ISHTI. dhe montimin e bombulave te gazit ne adresat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika , gërma ç,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte kerkuar qe operatori ekonomik te vetdeklaroje deklarimet e mesiperme pasi AK kërkon garanci qe furnizimi me gaz do te realizohet nga operatori ekonomik ne perputhje me standartin shqiptar te gazit dhe tollonet do kene vlefshmeri edhe ne vitin 2023.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të zoterojë 1(nje) automjet i cili duhet të jetë ne perputhje me kushtet e percaktuara ne VKM Nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)” e vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil.

Për këtë duhet të paraqesë leje qarkullimi, akt kolaudimin, siguracionin, çertifikaten per transportin e lëndëve të rrezikshme dhe foto të automjetit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kjo kerkese eshte vendosur ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)” pasi ofertuesi duhet te beje transportin e bombolave te gazit ne destinacionet e percaktuara nga AK duke permbushur kushtet teknike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: